



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 48, paragrafi (1), pika 3) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14) dhe pika 13) të Vendimit të përmbajtjes dhe mënyrës së funksionimit të Regjistrit të Kredisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 186/13 dhe 74/15), guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

Udhëzim

për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzuesit për zbatimin e Vendimit të përmbajtjes dhe të mënyrës së funksionimit të Regjistrit të Kredisë

(Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 83/2015)

1. Në Udhëzuesin për zbatimin e Vendimit të përmbajtjes dhe të mënyrës së funksionimit të Regjistrit të Kredisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 14/14) në pikën 1), pika ndryshohet me presje dhe shtohen fjalët: "si edhe mënyra e korrigjimit të të dhënave të gabuara."

2. Pika 5) ndryshohet siç vijon:

"Bankat dhe kursimoret dorëzojnë dhe përdoren të dhëna dhe informata deri te/nga Regjistri i Kredisë dhe bën korrigjim i të dhënave të gabuara, në pajtim me formatin e mesazheve elektronike të cilat rregullohen me udhëzime teknike për punën e aplikacionit të Regjistrit të Kredisë, të paraqitura në ekranin fillestar të hyrjes në aplikacion."

3. Në pikën 6), paragrafi (1), fjalët: "nga Vendimi nga i cili bankat dhe kursimoret detyrohen t'i dorëzojnë Regjistrit të Kredisë" ndryshohen me fjalët: "dhe pika 8-a) të Vendimit".

Në fund të nënparagrafit të pestë, pika ndryshohet me pikëpresje.

Pas nënparagrafit të pestë, shtohen dy nënparagrafë të re siç vijon:

- "- Shtojca nr. 6 – Kërkesë për korrigjim;
- Shtojca nr. 7 – Njoftim për korrigjim."

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), siç vijon:

"Bankat dhe kursimoret e korrigjojnë të dhënën e gabuar dhe marrin njoftim për korrigjimin e paragrafit (1) të kësaj pike me përdorimin e shifrat e definuara me shtojcat përkatëse."

Në paragrafin (4), i cili bëhet paragraf (5), fshihen fjalët: "përkatësisht vlera,".

4. Ky udhëzues hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

U nr. 17924
18 maj 2015
Shkup

Guvernatori
Димитар Богов

Shtojcë nr. 6

Kërkesë për korrigjim

Nr. Ren dor	Titulli i fushës	Përshkrimi i fushës	Plotësimi i detyrueshëm
1	2	3	4
1	Bankë	Numri amzë i bankës /kursimores	Po
2	Datë	Muaji për të cilin aplikacioni i Regjistrimit të Kredisë është aktualisht i hapur	Po
3	UpdType	E dhënë e cila ndryshohet	Po
4	Kod	Numri amzë NVAQ i klientit të dhënat e të cilit korrigjohen	Po
5	Nrtat	Numri tatimor NVAQ i klientit të dhënat e të cilit korrigjohen	Po
6	nrRK	Numri i partisë kreditore e cila korrigjohet	Po
7	nëDërg	Dërgesë në të cilën bëhet korrigjimi	Po
8	Fushë	Fusha që korrigjohet	Po
9	Vlera e vjetër	Vlera e vjetër e fushës që korrigjohet	Po
10	Vlera e re	Vlera e re e fushës që korrigjohet	Po

Shtojcë nr. 7

Njoftim për korrigjimin

Nr. R.	Titulli i fushës	Përshkrimi i fushës	Plotësimi i detyrueshëm
1	2	3	4
1	datë	Muaji kur është i paraqitur korrigjimi	Po
2	datëNga	Muaji kur bëhet korrigjimi i të dhënave	Po
3	datëDerinë	Muaji deri kur bëhet korrigjimi i të dhënave	Po
4	kod	Numri amzë NVAQ i klientit të dhënat e të cilit korrigjohen	Po
5	nrTat	Numri tatimor NVAQ i klientit të dhënat e të cilit korrigjohen	Po
6	kodN	Numri amzë NVAQ i klientit të cilit transferohet kërkesa	Po
7	nrTatN	Numri tatimor NVAQ i klientit të cilit transferohet kërkesa	Po